

# DREJTËSIA

## DITARI MUJOR

### MINISTRI MANJA DHE MINISTRI CUCI PASQYROJNË ARRITJET E 2022 DHE OBJEKTIVAT PËR VITIN 2023



Ministri i Drejtësisë Ulsi Manja, bashkë me Ministrin e Brendshëm Bledar Çuçi pasqyruan tablonë e gjithçka u bë në vitin 2022 dhe prioritetet për vitin 2023, përballë gazetarëve. Ministri Manja u shpreh se shtyllat e shtetit të së drejtës janë drejtësia, rendi e siguria publike. Përpos arritjeve të ministrive, Ministri Manja vlerësoi bashkëpunimin e ngushtë mes dy ministrive i cili kulmoi me zhvillimin e Ministerialit në Tiranë. Miratimi i hartës së re gjyqësore, shtyrja e mandateve të organeve të vetëgjyqësorisë, rritja e numrit të kandidatëve për shkollën e Magjistraturës, lehtësimi i stokut të dosjeve në Gjykatën e Lartë, miratimi i ndryshimeve në ligjin "Për trajtimin e pronës dhe procesit të kompensimit të pronave", miratimi i strategjisë ndërsektoriale të drejtësisë për të miturit, lufta kundër korrupsionit janë disa prej arritjeve të Ministrisë së Drejtësisë, theksoi Manja. Viti 2022 u mbyll me Pakon e Madhe, ku 4588 punonjës të sistemit të burgjeve përfituan 10000 lekë (të reja).

[LEXO PËR MË SHUMË](#)

### ANALIZA E REALIZIMIT TË DETYRAVE PËR VITIN 2022 DHE OBJEKTIVAT PËR VITIN 2023, MINISTRI MANJA TAKIM ME DREJTUESIT E INSTITUCIONEVE TË VARËSISË



Ministri Manja organizon një takim me drejtues të institucioneve të varësisë së Ministrisë së Drejtësisë, për të bërë analizën e realizimit të detyrave për vitin 2022, si dhe vendosjen e objektivave për vitin 2023. Manja theksoi që, nëse gjithësecili ka vullnetin dhe dëshirën për të kryer detyrën në mënyrë profesionale dhe dinjitoze, do të jemi pjesë e një ingranazhi të madh punësh të mira në zhvillimin dhe integrimin e vendit!

[LEXO PËR MË SHUMË](#)

### NËNSHKRUHET MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS



Ministri Manja në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorin e Shkollës së Magjistraturës z. Arben Rakipi për trajnimin e vazhdueshëm të koordinatorëve të rrjetit kundër korrupsionit. Trajnimi i koordinatorëve në Shkollën e Magjistraturës, nga ekspertët më të mirë vendas dhe të huaj, do të sjellë rezultate të prekshme dhe konkrete në luftën kundër korrupsionit, duke respektuar parimet themelore të shtetit të së drejtës, theksoi Ministri.

[LEXO PËR MË SHUMË](#)

### TAKIM PËRMBLEDHËS ME PRAKTIKANTËT QË JU BASHKUAN PRAKTIKËS KOMBËTARE TË PUNËS - THIRRJA VI



Ministri Manja organizon një takim përmbledhës me praktikantët që ju bashkuan Praktikës Kombëtare të Punës - Thirrja VI, pranë Ministrisë së Drejtësisë. Manja i falenderoi për punën e bërë në një vit dhe ndihmën e dhënë në strukturat kryesore të Ministrisë së Drejtësisë, si ajo e Kodifikimit, Përfaqësimit Gjyqësor, Arkiv-Protokolliit, Integritit dhe Burimeve Njerëzore. Ai shprehu bindjen e tij se eksperiencia e punës gjatë këtij viti do t'i shërbejë jo vetëm për të pasuruar CV-në, por edhe për të identifikuar aftësitë, në fushat që dëshirojnë të zhvillojnë.

[LEXO PËR MË SHUMË](#)

### MINISTRI MANJA TAKIM ME RAPORTEREN PËR SHQIPËRINË NË PARLAMENTIN EUROPIAN, ISABEL SANTOS



Ministri Manja u takua me Raporteren për Shqipërinë në Parlamentin European, Isabel Santos. Ecuria e reformës në drejtësi, zbatimi i hartës së re gjyqësore dhe garantimi i aksesit të qytetarëve të drejtësia, lufta ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar, mbrojtja kibernetike dhe siguria e të dhënave personale, ishin disa nga pikat e diskutuara në këtë takim. Gjatë takimi dypalësh, ata ndanë qëndrimin e përbashkët se përbashkja si duhet e këtyre detyrave shkurton rrugën e Shqipërisë drejt integritit në BE.

[LEXO PËR MË SHUMË](#)

### MINISTRI MANJA TAKIM ME AMBASADOREN E REPUBLIKËS HELENE, ZNJ. KONSTANTINA KAMITSI



Ministri Manja priti në një takim miqësor Ambasadoren e Republikës Helene, znj. Konstantina Kamitsi. Në këtë takim u diskutua mbi forcimin e bashkëpunimit dypalësh në fushën e drejtësisë, si dhe vënien në jetë të projekteve që u dakordësuan gjatë vizitës së Ministrisë së Drejtësisë në Athinë. Manja falenderoi znj. Kamitsi për mbështetjen që vendi fqinj i ka dhënë Shqipërisë në procesin e integritit në BE dhe intensifikimin më tej të partneritetit strategjik.

[LEXO PËR MË SHUMË](#)

### MINISTRI MANJA TAKIM ME MARY KATE BUTTERFIELD DHE JOSEPH R. BALDWIN



Ministri Manja priti në një takim kortezie dhe pune Mary Kate Butterfield, Këshilltare Ligjore Rezidente OPDAT dhe Joseph R. Baldwin, Këshilltari i ri Rezident Rajonal për Kundërterrorizmin pranë kësaj zyre. Në këtë takim u diskutua për ecurinë dhe zbatimin e plotë të reformës në drejtësi, si dhe për projekte të reja për të garantuar siguri maksimale në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

[LEXO PËR MË SHUMË](#)

### MINISTRI MANJA TAKIM ME ASAMBLENË E PËRGJITHSHME TË DHOMËS KOMBËTARE TË PËRMBARIMIT PRIVAT

Ministri Manja zhvilloi një takim me Asamblenë e Përgjithshme të Dhomës Kombëtare të Përmbarimit Privat në Republikën e Shqipërisë. Ministri i Drejtësisë kërkoi ngritjen e një grupi të përbashkët pune mes Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Përmbarimit Privat, të cilët do të kryejnë një vlerësim shterues të të gjithë problematikave mbi zbatimin e ligjit për përmbarimin privat dhe do të ndërmarrin hapat e duhura ligjore për funksionimin e këtij shërbimi me nxjerrjen e të gjitha akteve nënligjore sipas ligjit. Manja garanoi se ky shërbim shumë shpejt do të jetë jo vetëm një profesion i lakmueshëm për profesionistët e ligjit, por do të garantojë ofrimin me cilësi të shërbimeve përmbarimore për qytetarët dhe biznesin.

[LEXO PËR MË SHUMË](#)